



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3154/13 prot.

Datë 21/02/2024

V E N D I M
Nr. 205/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21/02/2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ATLANTIK” SH.A në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-88286-11-20-2023, me objekt, “*Shërbim për siguracion automjetesh TPL + kasko*” me fond limit 4,288,171 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 14.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

Ankimues: Operatori Ekonomik “ATLANTIK” SH.A me NIPT: K11807008V.
Adresa: *Rruga “Themistokli Germenji”, 3/1, Tiranë*

Autoriteti Kontraktor: Albpetrol sh.a
Adresa: *Selia Rruga Fier – Patos, km 7*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për*

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.11.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-88286-11-20-2023, me objekt, “*Shërbim për siguracion automjetesh TPL + kasko*” me fond limit 4,288,171 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 14.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

II.2. Në datë 01.12.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 05.12.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “ATLANTI” SH.A	4,224,850	leke	kualifikuar
-------------------	-----------	------	-------------

20.12.2023, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ATLANTIK” SH.A, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.11. Me shkresën nr. 10370/4 prot, datë 27.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 3154/5 prot datë 29.12.2023, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “ATLANTIK” SH.A, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.12. Referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor, rezulton se ky i fundit me shkresën nr. 10370/4 prot, datë 27.12.2023 ka vendosur:

“ [...] KSHA vlerëson se së pari Z.Hetem Xhamani nuk është vetëdeklaruar nga Operatori Ekonomik në asnjë nga rubrikat e formularit të Vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.9. Së dyti Autoriteti Kontraktor për përmbushjen e kriterit 2.3.2, e ka përcaktuar qartësisht dokumentacionin që kërkon të depozitohet nga operatorët ekonomik pjesëmarrës, me qëllim që ky kriter të quhet i përmbushur.

Kontrata e shërbimit e lidhur mes Hetem Xhameni dhe shoqërisë Atlantik sh.a nuk mund të konsiderohet një kontratë punë pasi kjo kontratë është lidhur referuar dispozitave të Kodit Civil dhe jo Kodit të Punës. Gjithashtu kontrata e shërbimit e lidhur me Hetem Xhameni është lidhur me këtë të fundit në cilësinë e personit dizik si subjekt tatimor me NIPT L51811010M. Në këtë kontekst Z.Xhamani paraqitet si subjekt tregtar dhe jo si individ i punësuar pranë shoqërisë Atlantik sh.a.

Nëse shoqëria Atlantik sh.a do të plotësonte kriterin e saj duke u mbështetur në kapacitetet e subjektit Hetem Xhameni me NIPT L51811010M, duhet të kishte lidhur një kontratë bashkëpunimi në formën e Bashkimit të Operatorëve sipas parashikimeve të LPP-së.

Në vijim paraqitja e “Statement of Bank” nuk provon kriterin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor për depozitimin e Listpagsave të shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit që provon se vlerësuesi i dëmeve është punësuar pranë operatorit ekonomik.

Hetem Xhameni paguan sigurime shoqërore dhe shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi, në emër të subjektit me NIPT L51811010M, ndaj pretendimi i operatorit ekonomik Atlantik sh.a nuk qëndron.

Përsa më sipër KSHA vlerëson se operatori ekonomik “Atlantik-Shoqëri Sigurimesh” sha, nuk plotëson kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në DST, dhe nuk përmbush kriteret ligjore të nenit 26, pike 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar. [...]”.

II.13. Me anë të shkresës 3154/7 prot., datë 29.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar operatorit ekonomik ankimues të paraqesë prova që vërteton datën e dorëzimit të formularit të ankesës procedurën e prokurimit objekt ankimi si më poshtë:

“Autoriteti kontraktor në informacionin e dorëzuar pranë KPP-së me shkresën nr. 10370/4 prot, datë 27.12.2023 me objekt: “Dërgim vendimi mbi ankesën e operatorit ekonomik “ATLANTIK – SHOQËRI SIGURIMESH”sh.a për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim për siguracion automjetesh TPL + kasko”, me Nr. REF-88286-11-20-2023”, protokolluar me tonën me nr. 3154/5 prot datë 29.12.2023, ka cituar shprehimisht: “... Ankesa e OE “Atlantik – Shoqëri Sigurimesh”sha është paraqitur online 2323-12-19, Nr. Aplikimi online: 3154/2023/Tipi i ankesës: V-Vlerësim.

...

Ankesa është rregjistruar nëpërmjet sistemit online të KPP, brenda afateve ligjore që parashikon neni 110 i LPP dhe si e tillë duhet të shqyrtohet në themel.”.

Sa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës të paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe nenit 30, pika 2 e nenit 53, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm të kërkojë nga ana e operatorit ekonomik ankimues “ATLANTIK” SHA paraqitjen e provave që vërtetojnë datën e dorëzimit të formularit të ankesës pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Sqarojmë se, bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, ku përcaktohet se: “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”.

II.14. Me shkresën nr. 929/6 prot, datë 02.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 3154/8 prot datë 05.02.2024, është depozituar nga operatori ekonomik në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i kërkuar nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

II.15. Me anë të shkresës 3154/9 prot., datë 08.02.2024, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor të paraqesë dokumentacionin fizik për procedurën e prokurimit objekt ankimi si më poshtë:

“Me shkresën nr. 10370/4 prot, datë 27.12.2023 me objekt: “Dërgim vendimi mbi ankesën e operatorit ekonomik “ATLANTIK – SHOQËRI SIGURIMESH” sh.a për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim për siguracion automjetesh TPL + kasko”, me Nr. REF-88286-11-20-2023”, protokolluar me tonën me nr. 3154/5 prot datë 29.12.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “ATLANTIK” SHA për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mos pranimi i ankesës, ku ndër të tjera ka argumentuar se: “... Ndërkohë në sistemin SPE dhe në dokumentacionin e paraqitur në formë shkresore rezulton dokumentacioni i vlerësuesit të dëmeve z. Hetem Xhameni ku mungojnë listpagesat e tre muajve të fundit dhe kontrata individuale e punës lidhur me kompaninë. ...”.

Sa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës të paraqitur në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe nenit 30, pika 2 e nenit 53, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon nga ana autoritetit kontraktor, Albpetrol SH.A që të vihen në dispozicion të Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacioni si më poshtë vijon:

1. Dokumentacioni fizik i dorëzuar nga ana e shoqërisë “ATLANTIK” SHA për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 të Shtojcës 8

“FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi, sipas përcaktimit të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 5 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.”.

II.16. Me shkresën nr. 939/1 prot, datë 13.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 3154/10 prot datë 15.02.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i kërkuar nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “ATLANTIK” SH.A mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të tij se: *“Për kriterin 2.3.2 të kapacitetit teknik të Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, ka depozituar:*

o Listepagesat e shoqerise per te pakten tre muajt e fundit qe provon se vleresuesi i demeve eshte i punesuar prane operatorit ekonomik ,kjo në kundërshtim me kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, të DST ku kerkohen:

- *Licenca si vleresues demesh*
- *Kontratë individuale pune e vlefshme.*
- *Listepagesat e shoqerise per te pakten tre muajt e fundit qe provon se vleresuesi i demeve eshte i punesuar prane operatorit ekonomik.*

Nderkohe ne sistemin SPE dhe ne dokumentacionin e paraqitur ne forme shkresore eshte rezulton dokumentacioni i vleresuesit te demeve z.Hetem Xhameni ku mungojne listpagesat e tre muajve te fundit dhe kontrata individuale e punes lidhur me kompanine” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 2.3.2 “Kapaciteti teknik” në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

2.3.2. *Licenca profesionale per te pakten nje person për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit në sigurime për dëmet materiale, leshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF)*

Për specialistin vleresues per demet materiale duhet të paraqiten:

- *Licenca si vleresues demesh*
- *Kontratë individuale pune e vlefshme.*
- *Listepagesat e shoqerise per te pakten tre muajt e fundit qe provon se vleresuesi i demeve eshte i punesuar prane operatorit ekonomik.*

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e specialistit në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.”.

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.3. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.1.4. Në nenin 41 pika 4 dhe 6 “Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

III.1.5. Në nenin 26 pika 2 dhe 6 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
 - b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
 - c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
 - ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
 - d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
 - dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
 - e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
 - g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
 - gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
 - h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
 - i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
 - j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
 - k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi
6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si

dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “ATLANTIK” SH.A konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nga ku rezulton se në pikën B: “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen) operatori ekonomik ka deklaruar në profilin e punonjësve vetëm dy punonjës përkatësisht 1. Venera Xhillari – Drejtor departamenti Shitjeve, 2. Enis Çela – departamenti i dëmeve.

Referuar dokumenteve të tenderit, në pikën 2.3.2. të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë se për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

2.3.3. *Licenca profesionale per te pakten nje person për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit në sigurime për dëmet materiale, lëshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF)*

Për specialistin vlerësues per demet materiale duhet të paraqiten:

- *Licenca si vlerësues demesh*
- *Kontratë individuale pune e vlefshme.*
- *Listepagesat e shoqërisë per te pakten tre muajt e fundit qe provon se vlerësuesi i dëmeve është i punësuar pranë operatorit ekonomik.*

Shënim: *Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e specialistit në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9.*

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

Në datën 05.12.2023 autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik të renditur i pari, të dorëzojë dokumentacionin e dorëzuar në rrugë elektronike si dhe dokumentacionin provues në mbështetje të neni 26 të të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar : “Kontratë Shërbimi lidhur me datë 06.01.2023, ndërmjetë shoqërisë së sigurimeve “ATLANTIK-Shoqeri Sigurimesh” sh.a dhe Z. Hetem Xhameni person fizik”, Liçencën “Për ushtrim veprimtarie vlerësues dëmsh në sigurime” nr. 172, datë 14.08.2019, Curriculum Vitae, “Statement of Account” të Z. Hetem Xhameni, si dhe fatura tatimore të lëshuara nga Hetem Xhameni në drejtim të operatorit ekonomik “Atlantik – Shoqeri Sigurimesh” sh.a.

Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar që në rastin e Për specialistin vlerësues për demet materiale duhet të paraqiten:

Licenca si vlerësues dëmsh

Kontratë individuale pune e vlefshme.

Listëpagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit që provon se vlerësuesi i dëmeve është i punësuar pranë operatorit ekonomik.

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “ATLANTIK” SH.A ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik si dhe pranë autoritetit kontraktor kontratën e shërbimit të lidhur ndërmjet shoqërisë së sigurimeve “ATLANTIK-Shoqeri Sigurimesh” sh.a dhe Z. Hetem Xhameni person fizik.

Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “ATLANTIK” SH.A me dokumentacionin e paraqitur, nuk provon se ka të punësuar një punonjës specialist vlerësues dëmsh, duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për stafin, pasi Z. Hetem Xhameni nuk rezulton në listpagesat e operatorit ekonomik ankimues, duke mos plotësuar këtë kriter kualifikues. Sa më sipër, KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik “ATLANTIK” SH.A duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Referuar kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për të vërtetuar kapacitetin teknik, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, kontrata e shërbimit e paraqitur nga operatori ekonomik “ATLANTIK” SH.A në procedurën e prokurimit, nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.2. kapaciteti teknik.

Sa me sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”,”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ATLANTIK” SH.A në procedurën e prokurimit “ *Procedurë e Hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-88286-11-20-2023, me objekt, “*Shërbim për siguracion automjetesh TPL + kasko*” me fond limit 4,288,171 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 14.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.
2. Autoriteti kontraktor, lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ATLANTIK” SH.A.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

